

# FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

## Programi 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

### Përmbajtja

1.	HYRJE.....	2
1.1.1.	PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 3280 .....	2
1.1.2.	QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT .....	6
1.1.3.	PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT .....	8
1.1.4.	PROJEKTET E INVESTIMEVE TË PROGRAMIT .....	11
1.1.5.	TË DHËNA MBI PROGRAMIN .....	13
1.1.6.	PROJEKTET E PLANIFIKUARA PER PBA 2022-2024.....	14

## 1. HYRJE

### 1.1.1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 3280

<b>Përshkrim i Përgjithshëm i Programit</b>		
Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.		
<b>Kodi i Programit</b>	<b>Emri i Programit</b>	<b>Përshkrimi i Programit</b>
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	<ul style="list-style-type: none"><li>• Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;</li><li>• Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;</li><li>• Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;</li><li>• Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj.</li></ul>

Gjatë vitit 2021 Bashkia Shkodër ka ofruar një shërbim të qëndrueshëm për mbrotjen civile në çdo pjesë të territorit të Bashkisë Shkodër.

Synimi dhe përpjekja jonë është fokusuar në:

- Përballimin e situatës për parandalimin dhe përhapjen e infeksionit nga COVID – 19.
- Ngritjen dhe zgjerimin e strukture së vullnetarëve civilë si pjesë e rëndësishme e strukturave të mbrojtjes civilë në partneritet me organizata e shoqërisë civile.
- Zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë përmes aktivizimit të shërbimit të mbrojtjes civile.
- Përmirësimin e sigurisë publike në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, duke siguruar informacion publik të vazhdueshëm për reziqet, aktivitetet e shërbimet Bashkisë, me prioritet parandalimin e situatave që çënojnë sigurinë e jetës dhe pronës së qytetarëve, bizneseve, aseteve administrative, pasurive kulturore, natyrore, etj.
- Vlerësimin e dëmeve nga specialistët e ngarkuar me urdhër të brendshëm dhe përlllogaritjet financiarë të vlerësimit për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.
- Hartimin dhe plotësimin e dokumentacionit për dhënie e ndihmës së menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie.
- Kryerjen e kontrollit sistematik vjetor dhe çertifikimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin te objekteve të Bashkisë sipas prioriteteve.
- Blerjen e fikseve automatike të zjarrit, rimbushjen e bombolave të fikseve automatike të zjarrit për objektet institucione publike në administrim të Bashkisë Shkodër.

- Rimbushjeen e bombulave e fikseve automatike të zjarrit në shkolla, bombulave të fikseve automatike të zjarrit për rimbushje gjendje pranë MZSH-se, dhe në godinën e Bashkisë Shkodër për përdorim në rast emergjence.
- Trajtimin dhe vlerësimin e akteve teknike për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin për objektet.
- Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për popullsinë: Shërbimi i MNZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Kjo strukturë ka kryer inspektimin, parandalimin, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrje për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave, ndërhyrje në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

**Sfida:**

- Përballimi i situatës të paparashikuar nga pandemia COVID – 19, vetëm me fondet e Bashkisë, pa asnjë transferim nga buxheti i shtetit.
- Mungesa e mjeteve te mjaftueshme për përballimin e situatave që krijohen nga emergjencat civile.

Tabela 1 Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

PBA 2022-2024								
<b>Raport</b>		<b>Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike</b>						
<b>Bashkia Shkoder</b>		<b>Institucioni-</b>						
<b>Programi</b>		3280	Mbrotjtja nga zjarri dhe mbrotjtja civile					
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2021	2022	2023	2024
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Buxh. Pritshëm	Plani	Plani	Plani
<b>Paga dhe Sigurime</b>								
Paga	600	27,823	27,451	38,267	35,446	36,717	36,717	36,717
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	4,581	4,573	9,556	6,730	5,840	5,840	5,840
<b>Korente</b>								
Mallra dhe Shërbime	602	8,044	13,116	76,253	53,726	8,097	8,097	8,097
Subvencion	603	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Brendshme	604	6,861	7,033	41,172	3,121	85,657	88,434	91,161
Transferta të Jashtme	605	0	0	0	0	0	0	0
Transferta për Familje & Individë	606	982	531	7,123	4,503	3,250	3,055	3,055
<b>Shpenzime Kapitale</b>								
Aktive të Paprekshme	230	0	2,807	3,000	2,000	0	0	0
Aktive të Prekshme	231	1,694	398	11,002	11,000	1,000	1,000	1,000
<b>TOTALI</b>								
		<b>49,985</b>	<b>55,909</b>	<b>186,373</b>	<b>116,526</b>	<b>140,561</b>	<b>143,143</b>	<b>145,870</b>

**Komente**

**Programi 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile** , ka si burim financimi transferten specifike, transferten e kushtezuar, transferten e pakushtezuar dhe te ardhurat e bashkise. Te ardhurat e programit zene mesatarisht 71.2 % ndersa shpenzimet neto jane shpenzime qe mbulohen nga transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e tjera mesatarisht me 28.8 %. Pjesen me te madhe te shpenzimeve e zene shpenzimet korrente me rreth 69 % per vitin 2022, 69.6 % per vitin 2023 dhe 70.1 % per vitin 2024. Ndersa shpenzimet per paga zene 30.3 % per vitin 2022, 29.7 % per vitin 2023 dhe 29.2 % per vitin 2024. Shpenzimet kapitale zene mesatarisht 0.7 % te shpenzimeve per te tre vitet.

## 1.1.2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Tabela 2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Tabela nr. 6

<b>POLITIKA E PROGRAMIT</b>					
<b>Programi Buxhetor Afatmesëm</b>		<b>2022-2024</b>			
<b>Programi</b>	<b>03280</b>	<b>Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile</b>			
<b>Përshkrimi i Programit</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbirneve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;</li> <li>• Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;</li> <li>• Shërbirne të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;</li> <li>• Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj.</li> </ul>					
<b>1</b>	<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	<p>Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përafrimi me standartet europiane të organizimit të mbrojtjes civile.</li> <li>2. Sigurimi i mbrojtjes civile në të gjithë territorin.</li> <li>3. 4. Informim publik për rreziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.</li> </ol> <p>Garantimi i shërbimit të zjarrfikësve në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</p>			
Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi		<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
Numri i stacioneve të MZSH që ka bashkia		1	1	1	1

	Numri i familjeve të trajtuara /ndryshimi në përqindje	0%	0%	0%	0%
<b>1.1.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.			
Treguesit e Performancës për Objektivin					
	Numri i familjeve përfituese që mbarështojnë blegtorinë në zonat e prekuara nga përmbytjet/ ndryshimi në përqindje	100%	33%	25%	0%
	Numri i kontrolleve sistematike vjetore për certifikimin për MZSH i objekteve të Bashkisë. /ndryshimi në përqindje	2%	18%	12%	24%
	Numri i ofruar i pajisjeve dhe kolaudimi i fikësve të zjarrit në institucione /ndryshimi në përqindje	11%	0%	0%	0%
	Numri i projekteve teknike për masat e MZSH në institucione /ndryshimi në përqindje	100%	8%	4%	4%
<b>1.2.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.			
Treguesit e Performancës për Objektivin					
	Zona e mbuluar nga shërbimi i MZSH në %	29%	29%	29%	29%
	Rritja e të ardhurave nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve / ndryshimi në përqindje	-50%	15%	13%	0%
	Reagim më i shpejtë ndaj njoftimeve për zjarre/ndryshimi në sekonda i daljes nga stacioni	0%	0%	0%	0%
	Efiçenca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH/ lekë/rast të menaxhuar	67.8	80.5	80.8	80.2
	Numri i thirrjeve nga popullata drejt Shërbimit Zjarrfikës - ndryshimi në %	-4%	5%	-5%	1%

Kryetari i NJVV		Kordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri:		Emri Mbiemri:		Emri Mbiemri:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Datë:		Datë:		Datë:	

### 1.1.3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Tabela 3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

<b>SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT</b>				
Programi Buxhetor Afatmesëm		2022-2024		
Programi	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile		
<b>1.1.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.		
<b>1.1.A.</b>	<b>Produkti</b>	Familje të trajtuara me ndihmë për blegtorinë në zonat e prekuara nga përmbytjet.		
	<i>Kodi i Projektit</i>	P03280.O1.A1.		
	Përshkrimi i Produktit:	Trajtimi me ndihma ushqimore për blegtorinë, për të minimizuar riskun e humbjes së krerëve të bagëtive.		
	Njësia Matëse	numër		
		<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	300	400	500
	Kosto totale (në mijë lekë)	84,040	85,657	88,434
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	280.1	214.1	176.9
	Ndryshimi në % i Sasisë		33.3%	25.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		1.9%	3.2%
	Ndryshimi në % i koston për njësi		-23.6%	-17.4%
<b>1.1.B.</b>	<b>Produkti</b>	Familje të trajtuara me shpërblim për fatkeqësi natyrore		
	<i>Kodi i Projektit</i>	P03280.O1.A2.		
	Përshkrimi i Produktit:	Dhënie e ndihmës së menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie. Dhënie e dëmit ekonomik (ndërtimor + orendi) për familjet me raste fatkeqësie.		
	Njësia Matëse	numër		
		<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	37	37	37
	Kosto totale (në mijë lekë)	3,000	3,000	3,000



	Kosto për njësi (në mijë lekë)	81.1	81.1	81.1	81.1
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		0.0%	0.0%	0.0%
<b>1.1.C.</b>	<b>Produkti</b>	Pajisje për fikje zjarri funksionale			
	<i>Kodi i Projektit</i>	P03280.O1.A3.			
	Përshkrimi i Produktit:	Kryerja e kontrollit sistematik vjetor dhe çertifikimi për MZSH iobjekteve të Bashkisë sipas prioriteteve. Blerja e fikseve automatike për objektet e tjera. Rimbushja e bombolave të fikseve automatike të zjarrit. Rifreskimi i akteve teknike për MZSH. Rimbushje bombulave të fikseve automatike të zjarrit në shkolla			
	Njësia Matëse	numër			
		<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	1,517	1,517	1,517	1,517
	Kosto totale (në mijë lekë)	3,000	1,000	1,000	1,000
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	2.0	0.7	0.7	0.7
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale		-66.7%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		-66.7%	0.0%	0.0%
<b>1.1.D.</b>	<b>Produkti</b>	Projekte teknike per masat e MZSH			
	<i>Kodi i Projektit</i>	P03280.O1.A4.			
	Përshkrimi i Produktit:	Realizimi i projekteve per mbrojtjen kundra zjarrit për godinat e Bashkisë Shkodër.			
	Njësia Matëse	numër			
		<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	50	54	56	58
	Kosto totale (në mijë lekë)	1,000	1,000	1,000	1,000
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	20.0	18.5	17.9	17.2
	Ndryshimi në % i Sasisë		8.0%	3.7%	3.6%
	Ndryshimi në % i kostos totale		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		-7.4%	-3.6%	-3.4%
<b>1.2.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.			
<b>1.2.A.</b>	<b>Produkti</b>	Raste të menaxhuara për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi			
	<i>Kodi i Projektit</i>	P03280.O2.A1.			

Përshkrimi i Produktit:

Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut. Mendohet të ngrihen edhe 2 stacione të tjera Zjarrfiksesh, njëri në zonën e NenShkodres (Velipoje ose Trush) dhe tjetri në zonën e MbiShkodres (Njesia administrative Mes). Hartimi i kalendarëve të gadishmërisë dhe grupeve. Hartimi i procedurave për kryerjen e shpenzimeve. Raportet e gadishmërisë.

Njesia Matëse	numër			
	2021	2022	2023	2024
	Buxheti	Plani	Plani	Plani
Sasia	640	620	615	620
Kosto totale (në mijë lekë)	43,418	49,904	49,709	49,709
Kosto për njësi (në mijë lekë)	67.8	80.5	80.8	80.2
Ndryshimi në % i Sasisë		-3.1%	-0.8%	0.8%
Ndryshimi në % i koston totale		14.9%	-0.4%	0.0%
Ndryshimi në % i koston për njësi		18.6%	0.4%	-0.8%

Kryetari i NJVV		Kordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri:		Emri Mbiemri:		Emri Mbiemri:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Datë:		Datë:		Datë:	

### 1.1.4. Projektet e Investimeve të Programit

Tabela 4. Projektet e Investimeve të Programit

PBA 2022-2024  
(000 ALL)

#### Projektet e Investimeve

<b>Bashkia Shkoder</b>	<b>Institucioni -</b>	
<b>Programi</b>	3280	<b>Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile</b>

Kodi Projektit	Emri i Projektit	Kosto Totale e Projektit	Burimi i Financimit	Data Fillimit	Data Përfund.	2019	2020	2021	2022	2023	2024
						Fakti	Fakti	Buxheti	Plani	Plani	Plani
1410402	Projektim i akteve teknike kundra zjarrit	2,807	Fondet e veta	2018	2020		2,807				
1410494	Blerje mjete		Fondet e veta	2021	2021			11,000			
1410571	Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe certifikimi për MZSH i të gjitha objekteve në		Fondet e veta	2021	2021			2,000	1,000	1,000	1,000

	varësi të Bashkisë.										
<b>1410201</b>	Blerje Pajisje TIK	400		2020	2020		398				
<b>1410319</b>	Blerje pajisje Kondicioner	290		2019	2019	262					
<b>1410408</b>	Blerje makinë zjarrfikëse	4,334		2019		0					
<b>1410472</b>	Blerje pajisje operacionale	2		2019		0					
<b>1410563</b>	Rikonstruksion Godinë të MZSH	1,710		2019	2019	1,432					
	<b>Totali</b>	<b>9,543</b>				<b>1,694</b>	<b>3,205</b>	<b>13,000</b>	<b>1,000</b>	<b>1,000</b>	<b>1,000</b>

## 1.1.5. Të Dhëna mbi Programin

Tabela 5 Të dhënat e Programit

<b>Të Dhëna Bazë mbi Programin</b>						
<b>Të Përgjithshme</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	
<b>Të dhënat e programit/ Vitet</b>						
Numri i familjeve përfituese që mbarështojnë blegtorinë në zonat e prekuara nga përmbytjet	0	300	400	500	500	
Familje të trajtuara me shpërblim për fatkeqësi natyrore	37	37	37	37	37	
Numri i kontrolleve sistematike vjetore për certifikimin për MZSH i objekteve të Bashkisë.	108	110	130	145	180	
Numri i stacioneve të MZSH që ka bashkia	1	1	1	1	1	
Numri i punonjësve MZSH	36	36	36	36	36	
Sipërfaqja territori e mbuluar me shërbim MZSH në km <sup>2</sup>	252.5	252.5	252.5	252.5	252.5	
Sipërfaqja totale e Bashkisë Shkodër km <sup>2</sup>	873	873	873	873	873	
Të ardhurat nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve (pajisja me çertifikata, etj) në mijë Lekë	1,314	660	760	860	860	
Numri total i rasteve të menaxhuara	403	640	620	615	620	
Koha e daljes nga stacioni në sekonda:	60	60	60	60	60	
natën	45	45	45	45	45	
ditën	7	7	7	7	7	
natën	7	7	7	7	7	
Buxheti total i MZSH në mijë lekë	37,007	43,418	49,904	49,709	49,709	
Numri i thirrjeve nga popullata drejt Shërbimit Zjarrfikës	528	508	534	508	515	
Numri i pajisjeve fikje zjarri funksionale	1,362	1,517	1,517	1,517	1,517	
Numri i projekteve teknike për masat e MZSH	0	50	54	56	58	

## 1.1.6. Projektet e planifikuara per PBA 2022-2024

Tabela 6 Emertimet e aktiviteteve

Projekte të planifikuara			000/lekë
Kodi i projektit/Emërtimi i Aktivitetit	Buxheti 2022	Buxheti 2023	Buxheti 2024
P03280.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër.	85,657	88,434	91,161
P03280.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie	3,000	3,000	3,000
P03280.O1.A3. Plotësimi dhe certifikimi për MZSH i pajisjeve për fikje zjarri i të gjithë institucioneve të Bashkisë	1,000	1,000	1,000
P03280.O1.A4. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH i të gjitha objekteve të varësi të Bashkisë.	1,000	1,000	1,000
P03280.O2.A1. Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit	49,904	49,709	49,709
<b>Totali</b>	<b>140,561</b>	<b>143,143</b>	<b>145,870</b>

Nr. 1	<b>P03280.O1.A1</b> Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër.	<b>Funksioni 3:</b> Rendi dhe siguria publike <b>N/Funksioni 032:</b> Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri <b>Llojet e programit: 03280:</b> Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
i. Situata		
<p>Baza ligjore:139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 29, LIGJ Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, VKM nr 965 date 02.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe krizave”, ligji 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, shkresa nr.2634/2 datë13.12.2019 e Ministrisë së Mbrojtjes “Mbi zbatimin e dispozitave të ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen civile.</p> <p>Bashkia Shkodër ka vijuar punën gjatë vitit 2021 për parandalimin e infektimit nga COVID-19,” duke përcaktuar detyrat konkrete për secilën drejtori dhe institucion varësie të Bashkisë Shkodër.</p> <p>Është realizuar blerja materialeve dizinfektuese për COVID 19 nga buxheti i Bashkisë. Me këtë shpenzim është realizuar blerja e materialeve për dezinfektimin e institucioneve, shkollave si dhe ambjeteve të tjera publike.. Ky proces është realizuar disa herë gjatë vitit, sipas vlerësimit të nevojave nga specialistët, duke i dhënë prioritet shkollave dhe institucioneve e ambjente të tjera publike që kane përqëndrim më të madh njerëzish dhe si pasojë rreziku për përhapje të infeksionit është më i madh.</p> <p>Bashkia Shkodër ka vijuar mbeshtetjen e familjeve në nevojë me produkte ushqimore dhe joushqimore te cilat janë blerë gjatë periudhës së pandemisë dhe janë ruajtur rezervat për raste të emergjencave civile.</p> <p>Pas përmbytjeve në dimër të këtij viti me situatën emergjente të krijuar, krahas mbështetjeve për banorët në Njësitë Administrative të prekura nga përmbytjet, është kryer edhe mbështetja me bazë ushqimore për blegtorinë. Përveç mbështetjes së menjëhershme në momentet e para nga subjekte të ndryshme, duke parë nevojën emergjente për mbështetje, u realizua shpenzimi me objekt “Blerje koncentratit për bagëti”, me të cilën u përballua situata deri në kthimin në normalitet pas tërheqjes së ujit nga banesat dhe sipërfaqes së tokave në zonat e përmbytura.</p> <p>Janë trajtuar nga buxheti i Bashkisë me ndihmë 300 familje me baze ushqimore për blegtorinë. Për këto familje janë dhënë ndihma edhe nga qeveria shqiptare dhe donator të ndryshëm.</p> <p>Është bërë riparimi i ndriçimit rrugor dhe trotuarëve të dëmtuar nga kushtet atmosferike, si pasojë e stuhisë në shtator të vitit 2020 me vlerë 1,555,285 lekë. Me këtë shpenzim është realizuar riparimi i dëmeve të shkaktuara nga stuhia kryesisht në unazën perëndimore dhe në disa rrugë të tjera.</p> <p>Janë realizuar punimet për mirëmbajtjen rruga Ura e Mesit-Prekal – Kir –Mali Shoshit –Breglumi-Ndërllysaj-Theth, njësia administrative Postribe-Pult –Shosh-Shalë.</p> <p>Është kontraktuar “Shërbimi për mirëmbajtje emergjente të akseve të rrugëve”. Me këtë shërbim është parashikuar marrja e mjeteve me qera për përballimin e situatës së pritshme gjatë të gjithë periudhës së dimrit nga reshjet e dëborës në zonat fushore dhe malore.</p> <p>Përsa i përket izolimit nga dëborë në zonat malore janë marrë masat si më poshtë:</p> <p>Është realizuar blerja e 40 ton kripë e zezë për emergjencat në rastet e borës dhe ngricave. Kjo sasi e cila është gjëndje mund të përdoret për përballimin e nevojave për mbajtjen hapur të rrugëve rurale dhe urbane si dhe për të rritur sigurinë si pasojë e ngricave.</p> <p>Është lidhur kontrata marrëveshje kuadër me objekt “Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të qytetit dhe të Njesive Administrative (zonat fushore)” ku janë parashikuar,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vënie në shërbim i dy borëpastruese për hapje rruge, 320 orë pune në zonat fushore.</li> </ul> <p>Këto mjete të specializuara janë parashikuar të ndërhyjnë në rrugët e qytetit dhe të njësitë administrative fushore, për të bërë të mundur pastrimin e borës në mënyrë që të sigurohen kushtet e qarkullimit në një kohë sa më të shpejtë të njerëzve dhe mjeteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vënie në shërbim i një fadromë për punime hapje rruge në raste emergjencash, 220 orë pune në zonat malore.</li> <li>- Vënie në shërbim i dy eskavatorëve për punime hapje rruge në raste emergjencash, 340 orë pune në zonat malore</li> </ul> <p>Me këto 3 mjete janë parashikuar ndërhyrjet për hapjen e rrugëve në aksin Ura e Mesit-Prekal – Kir –Mali Shoshit –Breglumi-Ndërllysaj-Theth , njësia administrative Postribe-Pult –Shosh-Shalë. Punimet e parashikuara janë zhblokimi i rrugëve nga dëborë në të gjithë aksin si dhe hapjen e rrugëve dhe riparimin e pasojave nga rreshqitjet e materialeve si gurë, dhëra etj.</p> <p>Me këto masa i kemi paraprirë ndërhyrjeve në kohë për hapjen e rrugëve nga bora për të bërë të mundur zvogëlimin e kohës së izolimit për banorët e këtyre zonave.</p>		

Rruga Qafë Thore-Theth është në administrim të subjektit sipërmarrës të kontratës së shërbimit që po kryen investimin me fonde të FSHZH-së.

Problemet e paraqitura:

- Pamjaftueshmëria e mjeteve për përballimin e situatave që krijohen nga emergjencat civile
- Nevoja për plotësim i strukturës së emergjencave civile sipas parashikimeve ligjore.
- Përballimi i situatës së përmbytjeve në Njësitë Administrative të prekura nga përmbytjet.

## ii. Synimi i projektit

Duke iu referuar

- Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile",

Synojmë:

- Shërbimi qëndrueshëm për mbrojtjen civile në cdo pjesë të territorit të Bashkisë Shkodër.
- Ngritja e strukturës së emergjencave civile në bashki në përputhje me ligjin, si dhe strukturës vullnetarëve civilë si pjesë e rëndësishme e strukturave të mbrojtjes civile.
- Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe realizimi i Mbrojtjes Civile.
- Përballimi e situatës për parandalimin dhe përhapjen e infeksionit nga COVID - 19
- Përmirësimi i sigurisë publike në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, duke siguruar informacion publik të vazhdueshëm për reziqet dhe aktivitetet e Bashkisë, me prioritet parandalimin e situatave që cenojnë sigurinë e jetës dhe pronës së qytetarëve, bizneseve, aseteve administrative, pasurive kulturore, natyrore, etj.

## iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Vlerësimi i disponibilitetit të burimeve njerzore për përfshirjen e tyre në planikimin dhe menaxhimin e EC.
- Mbledhja e të dhenave nga të gjitha kompanitë private për mjetet që perdoren nga ana e tyre dhe që mund të angazhohen në rast të EC.
- Masat parandaluese për përhapjen e infeksionit nga COVID - 19
- Masat paraprake për përballimin e situatave nga rreshjet.
- Përmirësimi i kapaciteteve teknike nëpërmjet realizimit të blerjes së mjeteve për përballimin situatave të EC
- Trajnim i stafit
- Mledhja e të dhënave për të gjithë personat, institucionet, ojf etj. Që kanë rol në planikimin dhe menaxhimin e EC.
- Hartimi i skemës së lajmërimit.
- Grumbullimi i të gjithë dokumentacionit ekzistues për vlerësimin e riskut në territor.
- Përgatitja e hartave të rrezikut për territoret që mungojnë.
- Takime në çdo NJA, rajon, lagje me perfaqësues komuniteti e struktura për hartimin e planit të masave që merren në rast rreziku.
- Vendosja e elementeve të sigurisë në institucionet publike si: shkalla e emergjencës, fikëset e zjarrit , hidrantetetj
- Sistemimi i kanaleve shkarkuese që rrezikojnë të sjellin gjendjen e EC.
- Sistemimi i rrugeve kryesore që mund të bllokohen nga dëborat.

Për vitin 2022 - 2024 shpenzimet parashikohen si më poshtë:

Llogaritja e fondit të mbrojtjes civile			
VITI	2022	2023	2024
<b>Burimet e veta</b>	<b>1,502,760</b>	<b>1,551,468</b>	<b>1,599,314</b>
<b>Totali 4% Fonde të kushtezuara</b>	<b>60,110</b>	<b>62,059</b>	<b>63,973</b>
Nga keto: transferte e pakushtezuar sektoriale			
Fonde të kushtezuara	60,110	62,059	63,973
<b>Fondet tona 1.7%</b>	<b>25,547</b>	<b>26,375</b>	<b>27,188</b>
<b>Total Fonde të planifikuara</b>	<b>85,657</b>	<b>88,434</b>	<b>91,161</b>

## b) Rezultatet që prisni

Bashkia Shkodër përballon në mënyrë optimale situatat e emergjencave civile (ka kontroll mbi iterritorin, ka plan emergjence masash, shërben duke iu përgjigjur nevojës emergjente))



<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
Bashkia Shkodër		Bashkia Shkodër				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2022</b>		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operativ e	Transferta
A.1	Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile	<b>85,657</b>				85,657
	<b>Shuma 2022</b>	<b>85,657</b>				<b>85,657</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operativ e	Transferta
	<b>Shuma 2023</b>	<b>88,434</b>				<b>88,434</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operativ e	Transferta
	<b>Shuma 2024</b>	<b>91,161</b>				<b>91,161</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2022 – 2024		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Personeli i Sektorit të Emergjencave Civile në Bashki <b>Institucioni likujdues:</b> Bashkia Shkodër				

Nr. 2	<b>P03280.O1.A2</b> Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie	<b>Funksioni 3:</b> Rendi dhe siguria publike <b>N/Funksioni 032:</b> Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri <b>Lojet e programit: 03280:</b> Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile				
<b>a) Përshkrimi i shkurtëri projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
Baza ligjore:139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore", Neni 29, LIGJ Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr 965 date 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimin në rastet e Emergjencave Civile dhe krizave" si dhe vecanerisht VKM 329, date 16.05.2012						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Është bërë vlerësimi i dëmeve nga specialistët e ngarkuar me urdhër të brendshëm dhe hartimi i preventivave për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore</li> <li>• Është plotësuar dokumentacioni për dhënien e ndihmës se menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie</li> </ul>						
Për të gjitha rastet e zjarrit në banesa është kryer verifikimi e hartuar dokumentacioni, është dhënë ndihma e menjëherëshme si dhe është bërë vlerësimi i dëmeve ekonomike (dëm ndërtimor në banesa + orendi)						
<b>Problemet e paraqitura:</b>						
